

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTEVE

R R E G U L L O R E

NR.14 Date 30.09.1988

Per mirembajtjen e vijave hekurudhore

Me qellim qe vija hekurudhore te siguroje nje levizje te pa nderprere dhe te sigurte te mjeteve hekurudhore, ne zbatim te nenit 10 te Kodit Hekurudhor te R.P.S. te Shqiperise , Ministria e Transporteve nxjerr kete.

R R E G U L L O R E

KREU I PARE

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Vija hekurudhore dhe pjeset perberese te saj.

Vija hekurudhore perbehet nga shtresa e siperme, ku hyjne : ballasti, traversat, shinat, nderrueset, aksesoret, kundrarreshqiteset e tirantet, shtresa e siperme ku hyjne: trupi i dheut, shtresa tamponit, kanalet kulluese dhe veprat e artit ku hyjne: urat, tombinat, tunelet, viaduktet, muret etj.

KREU I DYTE

SHTRESA E SIPERME E VIJES HEKURUDHORE

Neni 2

Ballasti

Ballasti perbehet prej cakulli ose zhavorri.

Linjat kryesore qe ndertohen te reja duhet te kene ballast cakulli

Ne linjat e dyta e degezime si dhe ne linjat ekzistuese qe jane me traversa druri, mund te perdoret ballast zhavorri, ne raste te vecanta per linja te dyta mund te perdoret ballast rere.

Cakulli, zhavorri dhe rerea e perdorur per ballast, duhet ti pergjigjet standarteve shteterore, kur hidhet per here te pare ne linje.

Prerja terthore e prizmit te ballastit duhet te jete sipas kushteve teknike te projektimit.

Gjate shfrytezimit te linjes, ne vartesi nga ndotja, ballasti cilesohet sipas tabelës se me poshteme.

Neni 3

Traversat

Traversat jane druri ose betoni, kur vendosen per here te pare ne linje duhet ti pergjigjen standartit shteteror ose kushtit teknik.

Numri i traversave per 1 km duhet te jete sipas kushteve teknike te projektimit ose projekteve te dala nga institucionet perkatese.

Nuk lejohet te kete ne linjen hekurudhore dy ose me shume traversa radhazi ne gjendje jo te mire teknike; gjithashtu lejohen deri ne dy traversa ne gjendje jo te mire teknike ne cdo 6 metra linje por me kushtin qe mbas cdo traverse jo ne gjendje te mire teknike te kete minimumin tre traversa qe te plotesojne standartet e tyre te punes.

Neni 4

Shinat

Ne vijen kryesore perdoren shina me peshe jo me pak se 42 kg/ml

Ne vija te dyta e degezime lejohen te perdoren shina me peshe 38kg/ml ne raste te vecanta ne linja magazinash ose tubiqe perpunimi lejohet te perdoren shian me peshe deri 35 kg/ml

Gjatesia e shinave duhet te jete mbi 12m

Ne cdo distance ndermjet dy nderruesve qofte dhe ne linje kryesore mund te lejohet vetem nje cift shinash me gjatesi jo me te vogel se 6 metra.

Shina quhet e konsumuar dhe duhet te hiqet nga linja kur arrin vlerat e treguara ne tabelen e meposhteme.

Neni 5

Pjerresia e shines

Shinat pjerresohen ne planin 1:20 nga ana e brendeshme e linjes.

Ne nderuese nuk behet pjerresim i shinave.

Kalimi nga shinat nuk behet me pjerresin 1:20 ne shinat e nderruesve behet nepermjet pjerresise 1:40

Neni 6

Gjersia e linjes

Gjersia e vijes eshte distanca ndermjet faqeve te brendeshme te kokave te shines (faqet e punes ku takon buza e bandazhit) e matur 14mm nen siperfaqen e siperme te kokes se shines

Ne vije te drejte dhe ne kthesa me rreze 500m e me shume gjersia e vijes duhet te jete 1435 mm

Ne vijat me kthesa me rreze me te vogla se 500m vija zgjerohet sipas tabeles se meposhteme.

Ne kthesat rrethore me kurbe parabolike zgjerimi fillon ku rrezja R-500M dhe mbaron me MKP (mbarimi i kurbes parabolike)

Zgjerimi behet gradualisht ne menyre te vazhduar dhe nuk duhet te jete me shume se 2mm per 1m vije per shpejtesi levizje deri 80km/ore ndersa 800-100 km/ore 1.5mm

Distanca X1 nga fillimi i zgjerimit jepet me formulen

Zgjerimi ne nje pike te cfaredoshme jepet me formule.

R – rrezja e ktheses ne metra

L – gjatesia e kurbes parabolike

X – distance nga fillimi i zgjerimit me metra

E – zgjerimi i plote

Ex – zgjerimi i kerkuar

Ne kthesat pa kurba parabolike zgjerimi behet ne pjesen e drejte para ktheses rrethore por jo me shume se 10mm, pjesa tjeter behet ne kthesen rrethore.

Gjate marrjes ne dorezim te vijave hekurudhore si ato te reja ashtu dhe ato qe mememetohen lejohet te kete luhajte nga normat e mesiperme + -3mm

Gjate shfrytezimit te viejs lejohen toleranca ne gjeresi nga normativat si me poshte.

- a. Per shpejtesine nga 80 km/ore deri 100 km/ore -3mm dhe +8mm
- b. Per shpejtesi nga 60km/ore deri 79 km/ore -4mm dhe +10mm
- c. Per shpejtesi me te vogel se 60 km/ore lejohet -5mm dhe +15mm

Ne vije nuk lejohet gjersi me te vogla se 1430 dhe me te medha se 1470 mm duke patur parasysh dhe konsumin e shines.

Neni 7

Niveli i shinave

Kokat e shines ne prerjen terthore te cdo pike qe ndodhet ne viej te drejte duhet te jene ne nje nivel

Nivelimi i vijes ne vije te drejte dhe ne kthese

Ne pjeset e drejta te vijes siperfaqet e siperme te kokave te te dy vargjeve te shianve dueht te jene ne te njejtin nivel ne cdo prerje perpendikolare ne boshtin e saj.

Lejohet qe njeri varg shianash te jete 4mm me lart se tjetri ne pjeset e drejta. Ky mbilartesisim lejohet te behet ne urat qe jane me shtrese ballsti. Ne te gjitha urat e tjera e tunelet si dhe ne te dy anet e tyre ne nje gjatesi 25m nuk lejohet mbinaltesimi 4mm

Ne hekurudhat e reja dhe atyre qe meremetohen ne kohen e marjes ne dorezim lejohet toleranca + - 4mm

Ne kthesa ne varesi nga rrezja dhe shpejtesia e levizjes, behet mbilartesimi i vargut te jashtem te shianve sipas formule

H – mbilartesimi i shines se jashteme

V – shpejtesia e levizjes se trenit

R – rrezja e ktheses

Mbilartesimi me i madh lejohet deri ne 125mm

Ne hekurudhat e reja dhe ato qe meremetohen ne kohen qe vihen ne shfrytezim lejohet te kete nje tolerance prej + - 5mm

Ne vijat qe jane ne shfrytezim lejohet nje tolerance + - 10mm si ne drejtim ashtu dhe ne kthese.

Kalimi nga pjesa e vijes me shina ne nivel deri tek mbikalimi i plote behet nepermjet rampes me pjerrresi 1:1000 e cila lejohet te shkoje deri ne 1:5000

Gjatesia e rampes kaluese perthithet ne gjatesine e kurbes parabolike.

Tek kthesat rrethore pa parabolike rampa e mbingritjes behet ne vije te drejte ne menyre qe ne te gjithe kthesen rrethore te kete mbinaltesim te plote.

Neni 8

Shigjetat e kthesave

Kontrolli i vijes ne plan behet me anen e instrumentave ose me anen e matjes se shigjetave me anen e nje filli.

Nje vije e rregullt ne plan kur eshte ne vije te drejte nuk duhet te kete shigjeta (pra shigjetat duhet te jene zero) ndersa kur ndodhet ne kthesa te gjitha shigjetat e rrethores duhet te jene te barabarta. Ne kurbat parabolike shigjetat ndryshojne ne varesi te pozicionit ku kryhet matja. Madhesia e shigjetes ne kthesen rrethore llogaritet me formulen

F - shigjeta e fillit

d – gjatesia e fillit

r – rrezja e ktheses ne metra

Ne nje pike cfaredo te kurbes parabolike shigjeta duhet te jete

f_x = shigjeta ne distancen x nga fillimi I kurbes parabolike.

d – gjatesia e fillit ne metra

x – distanca nga fillimi i kurbes parabolike ku kerkohet shigjeta

l – gjatesia e kurbes parabolike ne metra

kur vihen ne shfrytezim hekurudhat e reja ose mbas meremetimit te ekzistuesve shigjetat lejohen te kene keto toleranca.

Per V me te vogel ose te barabarte me 60km/ore lejohet te kete nje ndryshim te shigjetave fqinje deri ne ----- ndersa per shpejtesi mbi 60 km/ore lejohet -----

Gjate shfrytezimit te vijes lejohen keto toleranca te ndryshimit te shigjetave fqinje.

Per shpejtesine V me te vogel ose te barabarte ose te barabarte me 60km/ore $D_f = 1.25d$

Per shpejtesi me te madhe se 60km/ore -----

D_f – ndryshimi ndermjet shigjetave fqinje (te njepas njeshme)

Ne kurba parabolike diferenca ndermjet dy shigjetave fqinje mund te jete me e madhe ose me e vogel vetem per madhesine D_f si ne rastet e mesiperme per kthesat rrethore.

Pra diferenca definitive ndermjet dy shigjetave duhet te jete baraz me $m + -D_f$

m – diferenca ndermjet dy shigjetave te llogaritura sipas formulese se mesiperme per kurben parabolike.

Shigjeta per pjeset e drejta te vijes kur ne te krijohen shtremberime lejohen si me poshte.

Per vija te reja dhe ato qe meremetohen kur vihen ne shfrytezim per shpejtesi te barabarte ose me te vogel se 60 km/ore dhe per korda (fill) me gjatesi 10m lejohen $+ - 2mm$ ndersa per shpejtesi mbi 60km/ore lejohet $+ - 1mm$

Per vijat gjate shfrytezimit po per dill me gjatesi 10m lejohet per shpejtesi te barabarte ose me te vogel se 60km/ore $+ - 3mm$ ndersa per shpejtesi mbi 60km/ore lejohet $+ - 2mm$

Neni 9

Nderrueset

Nderrueset duhet te jene me dimensione ne perputhje me vizatimet e projektet e miratuara.

Nderruesja duhet te kete shian te te njejtit tip.

Ne rastet kur tipi i shines se nderruesve eshte i ndryshem nga ai i shines se vijes ne te cilen montohet kjo nderruese duhet te pakten 6m nderruesja te zgjatet ne te tre drejtimet e saj me shina te te njetit tip si tek venderrueset.

Ne vijat kryesore dhe te pranim nisjes nderrueset duhet te jene te markes jo me te medha se 1:9. Ne vijat e tjera mund te pranohen dhe nderruese te markes deri 1:7

Nderrueset duhet te jene te pastruara dhe te evajisura ne nyjet qe levizin, ne jasteket ku mbeshtetet gjilpera dhe ne faqet anesore te gjilperes ku frekuentohet buza e bandazhit, ne nje gjatesi 2m nga fillimi i majes se gjilperes. Kokat e shinave ne nderruese normalisht duhet te jene ne te njejtin nivel. Disnivele ne kokat e shinave mund te lejohet ne + - 10mm

Nuk lejohet te kete ne nderruese qofte dhe nje nga te metat e meposhtme.

- Hapja e gjilperes nga shina me shume se 4mm
- Gjilpera te palidhura me shtange
- Shtremberime te gjilperes
- Ulje te gjilperes nga shina baze me shume se 2mm
- Shtremberime te gjilperes
- Ulje te gjilperes nga shina baze me shume se 2mm ne seksionin ku gjilpera ka gjeresi 50 mm ose me shume
- Thyerje te gjilperes shines baze ose te zemres
- Keputjen e dy ose me shume bullonave te kondrashines
- Kur ka kaluar normat e konsumit te pjeseve te nderrueses si me poshte.

Normat e konsumit te pjeseve te nderruesve

Ne dimensionet e nderruesve lejohen keto toleranca nga ato te vizatimit apo projektit te miratuar

Ne lidhje para majes se gjilperes	+5 dhe -3
Ne majen e gjilperes	+6 dhe -2
Ne rrenje ne drejtim	+5 dhe -3
Ne rrenje ne kthese	+5 dhe -3
Ne shinat kalimtare ne drejtim	+5 dhe -3
Ne shinat kalimtare ne kthese	+8 dhe -3
Ne zemer ne drejtim	+6 dhe -2
Ne zemer ne kthese	+6 dhe -2
Ne distancen nga zemra deri tek faqja e punes e kundrashines	+2 dhe -2
ne ullukun e kundrashines	+2 dhe -2

KREU I TRETE

VEPRA E ARTIT

Neni 10

Veprat e Artit

Veprat e artit duhet qe ne cdo kohe te jene ne gjendje teknike te rregullt si nga ana konstruktive ashtu dhe funksionale per te perballuar te gjitha veprimet qe lindin nga mjetet levizese dhe nga ato te natyres te parashikuara qe ne projektin e tyre.

Neni 11

Urat

Hapesira e dites duhet te jete e lire per perballimin e prurjeve maksimale te parashikuara ne projektin e vepres.

Nuk lejohet te kete grryerje te themeleve te mbeshtetjeve te urave

Per cdo rast vlerat e lejuara (ne cm) nuk duhet te jene me te medha se:

- a. Cedimi i plote i njetrajteshem i mbeshtetjes 1.5VL
- b. Ndryshimi i uljeve te njetrajteshme te dy mbeshtetjeve te njepasnjeshme 0.75 VL
- c. Zhvendosja horizontale e mbeshtetjes ne jastek 05. VL ku L eshte gjatesia e hapesires me te vogel te mbeshtetjeve qe llogarisim, e shprehur ne metra dhe qe meret jo me e vogel se 25 m

Kuzhinetat e mbeshtetjes se trareve duhet te jene te pastruara dhe te vajisen vazhdimisht, pjeset e tjera metalike duhet te jene te bojatisura.

Burimet e kullimit te ujrave duhet te jene gjithnje te lira

Nuk duhet te jene te zbuluara hekurat e punes.

Fugat mes trareve dhe soletoneve te jene te lira.

Neni 12

Tombinot

Tombinot duhet te jene te lira ne te gjithë seksionin e tyre.

Nuk duhet te kete shkeputje te pertalit nga tubi i tombinos, si dhe spostime te unazave njera nga tjetra.

Neni 13

Tunelet

Tunelet ne te gjithë seksionin e tyre te brendeshem nuk duhet te kene permasa me te vogla se ato te projekteve te ndertimit ose riparimit.

Ujrat e tuneleve duhet te disiplinohen ne kanalet anesore.

Nuk lejohet qe ne kanalet dhe muret anesore te tuneleve te kete zgavra

Gjate ndertimit te veprave te artit ndermarja zbatuese Drejtoria e Pergjitheshme e Hekurudhave dhe Inspektoriat Hekurudhor ushtrojne kontrole sistematike mbi cilesite e materialeve, saktesine e zbatimit te projekteve, dokumentacionin per punimet e maskuara si dhe te gjithë dokumentacionet e tjera qe jane te detyrueshme te mbahen ne veper dhe qe sherbejne ne maredheniet zbatues-investitor, duke respektuar dispozitat perkatese ne fuqi.

Me marjen ne dorezim te veprave te artit nga sektoret e mirembajtjes, krijohet dokumentacioni teknik per cdo objekt te vecante.

Veprat e artit ne te gjithë vijen hekurudhore kontrollohen periodikisht duke rregjistruar ne librat perkates te cdo objekti gjendjen e konstatuar dhe masat e nevojshme te mirembajtjes.

Ne rast se veprat e artit kane demtime te rendesishme, krijohet nje komision projektues (I.S.P. nr. 2) zbatues-shfrytezues per percaktimin dhe marjen e masave per venien e objektit ne kushte pune normale.

Kur nevojiten ndryshime te paparashikuara ne projekt, nje komision projektues (I.S.P. nr. 2) shfrytezues studion dhe percakton menyren e zgjidhjes dhe zbatimit te punimeve qe lindin nga nevoja per kete ndryshim.

KREU I KATERT

TRUPI I DHEUT

Neni 14

Trupi i dheut duhet te siguroje qendrueshmerine e mbishtreses hekurudhore pavaresisht nga ndryshimet e rregjimit te temperatures ose te ujrave. Ne trupin r dheut hyjne dhe shtresa e tamponit, kanalet anesore, drenazhet, si dhe brezi i kufirit hekurudhor.

Gjate marjes ne dorezim te hekurudhave te reja dhe atyre qe rikonstruktohen duhet te behet kontrolli i kurores se trupit dhe te dheut si:

- kontrolli i kuotes ne aks dhe skaj te bankines
- kontrolli i karakteristikave kryesore si ngjeshje, lageshti, kapilaritet etj
- kontrolli i siperfaqes se kurores
- kontrolli i shtreses se tamponit etj

Rezultatet e te cilave duhet te jene ne perputhje me kushtet teknike te projektimit dhe te zbatimit

Nuk lejohet te krijohet balte ne kuroren e trupit te dheut, cedime, shkarkime etj, qe shkaktojne ndryshime ne parametrat gjeometrike te shtreses se vijes.

Nuk lejohet te kete te cara ne trupin e dheut te cilat mund te lejojne futjen e ujit ne te.

Bankina duhet te jete gjithnje e rregullt dhe me pjerresi 4 %

Nuk lejohet te kete barera ne bankine

Nuk lejohet qe gjate pastrimit te kanaleve dherat te hidhen ne bankine

Nuk lejohet shtrirja e kabllave ose tubacioneve te ndryshme si dhe e shtyllave ne bankinat e trasese se ndertuar me dhera argjilore pa projekte te miratuara.

Lejohet te vendosen ne bankinat treguesit e vijes dhe shenjat perkatese qe i sherbejne levizjes duke respektuar gabaritet e afrimit te ndertimeve

Ne rast se ka cedime te trupit te dheut te ndertuar me dhera argjilore qe shoqerohen ne deformime te shtreses se sipërme te linjes behet ndertimi i tamponit te pjeseshem ose te plote ku kurores se re i jepet pjerresi 10 %

KREU I PESTE

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 15

Shkelja e dispozitave te kesaj rregulloreje ku nuk formon veper penale, denohet si kundra vajtje administrative ne baze te neneve 40-43 te Kodit Hekurudhor.

MINISTRI

Luan BABAMETO

